



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

| | |
|--------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Datë/Datum/ Date: | 10.09.2024 |
| Për/Za/For: | z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit |
| CC: | z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit |
| Nga/Od/From | z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari |
| Lënda/Subjecat/Subject: | Raporti për muajin Gusht |

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë dhe Pylltarisë për periudhën 01.0.8.2024 deri me 31.08.2024

RAPORTI PËR MUAJIN GUSHT - 2024

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Drejtorati bujqësisë ka mbajtur takime të rregullta mujore me staf dhe ka diskutuar rreth përfundimit të projektve, atyre që janë në process dhe bashkëpunimëve të ardhshme me donator dhe organizata të cilat operojnë në Kosovë.

Projekti i serave me organizatën IRK ka përfunduar dhe janë muntuar të gjitha serat të fermerët përfitues.

Gjatë mujait Korrik drejtorati bujqësisë i ka pranuar të gjitha dokumentacionin e fermerëve të cilët kanë dorzuar fakturat e plehut mineral dhe sasin e grurit në kuader të pagesave direkte që është hapur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nga data 1 gusht deri me 2 shtator 2024. Gjatë kësaj periudhe kanë aplikuar mbi 1500 fermer.

Gjithashtu, jemi duke vazhduar me projektin e zhavorimit të rrugëve fushore të cilat janë shumë të nevojshme për fermerët tanë, ku ju krijojmë mundesi dhe qasje me të lehtë në tokat e tyre.

Gjithashtu jemi duke bërë trajtimin e qenëve endacak sipas kërkesave të banorëve në lokacione të ndryshme në komunën tone.

Gjatë muajt Gusht kemi nënshkruar marrveshje të bashkëpunimit me organizatën IADK për zhvillimin e bujqësisë, ky projekt ka qenë për komunitetet pakic që jetojnë dhe veprojnë ne Komuën e Lipjanit. Vlera e këtijë projekti kap shumën prej 66,700 euro. Veç tjerash nga ky memorandum, është paraparë që të punësohen edhe 50 qytetar nga komuniteti në kompani të ndryshme që operojnë në Lipjan në sektorin e bujqësisë.

Në projektinë për gjetjen dhe hapjen e burimëve të ujit me organizatën QATAR CHARITY jemi duke dalur në teren.

Komisioni për vlerësimin e dëmëve është duke pranuar kërkesa të ndryshme dhe duke dalur në teren për të pare dhe verifikuar dëmet e shkaktuara nga faktor të ndryshëm.